



**VENDIM**

*Nr. 17, Datë 19.01.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË  
SË LLOGRATIJES SË TARIFAVE TË SHOQËRISË SË PRODHIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE AKSIONE E SË CILËS  
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT APO PJESËRISHT NGA SHTETI  
DHE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 16; 20/a; 108/3 dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e ”draft–Metodologjisë së llogaritjes së Tarifave të Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.” të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “draft–Metodologjisë së llogaritjes së Tarifave të Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE  
Petrit AHMETI**